



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 55, datë 27.03.2019

**PËR MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN
E PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK PËR DËMET QE U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI” TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 10 të Ligjit 10 076, datë 12.02.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 14, të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Analizës së Riskut, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL të sigurimit, tabela 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shoqëria publikon primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Tabela e primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete për kontratat TPL të sigurimit:

Tabela 1

KAT	KLASA	TIPI	Kapaciteti Motorik (cm³)ose pesha bartëse (T) ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlllogaritura (në lekë)
A 1		Motorcikleta	Kapaciteti Motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	1,700
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	2,500
B 1		Autovetura	Kapaciteti Motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm ³	3,800
	B 1/2		Mbi 1600 cm ³	5,300
B 2		Furgona, Mikrobuze	Nr Vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	7,300
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	10,000
C 1		Autobuse	Nr Vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	16,400
D 1		Kamiocina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	6,900
D 2		Kamione	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	11,500
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)	3,400
F		Mjete bujqësore		2,600
G		Zjarrfikëse		6,000